



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 58

Prishtinë, më 29.03.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami .

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office, Dren Ajeti – GLPS, Sanije Berisha – OSBE, Senada Halimi- “Zëri”, Amire Qamile – BIRN, Albulena Mavraj, “Epoka e Re”, Agon Foniqi dhe Driton Vitia – “Kosova Sot”, Genc Jaha – KDI, Floriana Merovci- ZRPK dhe Sahadete Zogaj- “Kosova Press”.

Stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.3.2016;
3. Diskutim lidhur me mandatin e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.03.2016

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.03.2016, pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me mandatin e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Kryesuesja, në fjalën e saj, tha se ne tashmë kemi hyrë në gjashtë mujorin për hapjen e konkursit dhe sqaroi bazën ligjore për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, sipas Ligjit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke ju referuar nenit 8 të këtij Ligji.

Armend Zemaj, tha se kompetent për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit është ky Komision. Mendoj se duhet të jemi në koherencë me procedurat dhe afatet ligjore dhe është bërë mirë që është vendosur në rend të ditës, kështu që sot të procedohet në procedurat e mëtejshme sipas praktikave të mëhershme, por duke u bazuar në ligjin e ri të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Në të kaluarën, për shkak të zvarritjes së procedurave, ka pas mangësi të udhëheqjes së këtij institucioni. Brenda këtij gjashtë mujori të bëhet zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe besoj se Kosova ka potencial intelektual për këtë.

Zemaj bënte thirrje dhe e inkurajoi gjeneratën e re, që kanë kapacitete intelektuale, mediat, shoqërinë civile dhe njerëzit e ndryshëm që kanë punuar dhe që i njohin këto fusha, të bëhen pjesë e këtij konkursi, duke shprehur besimin se drejtor në Agjencinë Kundër Korrupsion do të zgjidhet një njeri me kredibilitet, i cili do ta ushtrojë këtë detyrë me nder dhe përkushtim.

Agim Aliu, tha se ajo me të cilën ne do të duhej të merreshim në ardhmen, është çështja e Ligjit, pasi që ne kemi filluar një proces ku jemi duke bërë një lloj ekuivalence të çështjes së mandateve të agjencive të ndryshme, që të cilat jemi duke i diskutuar në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ne tashmë kemi kaluar disa nga agjencitë, ku kemi theksuar që një mandat të jetë 5 vjeçar dhe jo dy mandate rresht, nga 5 vite. Ndoshta do të ishte mirë të shikohet mundësia që edhe me Agjencinë Kundër Korrupsionit, të jetë njëjtë ashtu si kemi vepruar në raste tjera sepse ju e dini që kemi ndërhyrë edhe në punën e komisioneve tjera, duke ju rekomanduar që të jetë vetëm një mandat 5 vjeçar ose të jenë dy mandate, por të shkurtohet mandati në 2 (dy) vite.

z. Aliu, më tej shtoi se mandati i drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, duhet të kufizohet vetëm në një mandat 5 vjeçar ose në dy mandate, por të jenë nga 2 (dy) vite sepse 10 (dhjetë) vjet për një drejtor janë shumë. Prandaj, pas përfundimit të procedurave dhe përzgjedhjes së drejtorit të ri, të shikohet mundësia e amendamentimit të tillë në Ligj, ndërsa afati i konkursit mendoj se duhet të jetë 15 ditë nga dita e shpalljes së tij.

Kryesuesja, tha se sa i përket çështjes së mandateve, është fakt që kemi filluar një praktikë për mandatet që kanë shumë vite ose të shkurtohen, ose të mos lejohet mundësia e rizgjedhjes në të njëjtën detyrë sepse në një institucion kaq të ndjeshëm siç është Agjencia Kundër Korrupsionit 10 (dhjetë) vjet për një person janë shumë.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Të shpallet Konkursi për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit;

Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit që është miratuar në Komision;

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Raportin me Amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme.

Komisioni vendosi që mbledhja e ardhshme të mbahet më 12.4.2016, në orën 13:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:

Fatbardha Boletini

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi